



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/128
Datë: 16.02.2023


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi 4 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 8 të Ligjit Nr. 08/L-117 për Qeverinë e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 02/2021 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 04/2021 dhe me Rregulloren Nr. 03/2022, nenit 70 pika 2. të Rregullores së Kuvendit të Republikës së Kosovës, në pajtim me nenin 17 dhe 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 16 shkurt 2023, merr këtë:

V E N D I M

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, në pajtim me kërkesën e Kuvendit të Republikës së Kosovës Nr. prot. 08/3408/L-214 të datës 9 shkurt 2023, jep mendim lidhur me Nismën Legjislative për Projektligjin për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës e vlerëson Nismën Legjislative të iniciuar nga deputetët propozues të Kuvendit të Republikës së Kosovës për miratimin e Projektligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158.
3. Ministria e Financave, Punës dhe Transfereve vlerëson se për nga aspekti i ndikimit buxhetor, Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, nuk krijon kosto shtesë buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës.
4. Ky Vendim së bashku me mendimin e dhënë nga Ministria e Ekonomisë, Opinionin e Departamentit të Buxhetit të MFPT-së dhe Opinionin ligjor të përputhshmërisë me Acquis të BE-së të Zyrës Ligjore - ZKM, i procedohet Kuvendit të Republikës së Kosovës.

5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Albin KURTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- Të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-së
- Arkivit të Qeverisë